

Edicion Special

Muri që ndryshoi historinë.

Rënia e Murit të Berlinit hapi portat e lirisë për Shqiptarët.



Rrëzimi i Statujës së diktatorit Enver Hoxha

Rënia e Murit të Berlinit 20 vjet më parë ishte shpresa më e madhe për Shqiptarët se dikë do të ndryshonte dhe në realitetin e tyre 50 vjeçar të regjimit totalitar Komunist, ndarjes nga bota, izolimit total mungesës së lirisë dhe të drejtave demokratike. 20 vite pas rrezimit të Murit të Berlinit kujtesa e njerezve që jetuan atë ndryshim historik është e gjallë. Pamjet e të rinjve, studenteve, intelektualëve dhe qytetarëve të Tiranës në revoltat e viteve 90 janë të freskëta dhe protagonistët e atyre viteve kujtojnë se tek çdo shqiptar flladi i lirisë, pas rënies së Murit të Berlinit, nisi të ndjehet. Revolta studentore e vitit 1990 ishte manifestimi i parë i kurajos qytetare të intelektualëve, të cilët kundër regjimit kërkonin fitoren e lirisë, demokracisë dhe shtetit ligjor. Lideri i levizjes studentore demokratike në Shqipëri Sali Berisha në një prej aktiviteteve të shumta të këtij përvjetori botëror është shprehur gjatë një prezantimi në konferencën "Vitet 1989/1990: Era e ndryshimit në Shqipëri" se: "Shqiptarët në atë kohë përjetonin izolimin më të thellë në tërë historinë e tyre. Ndër të gjitha vendet e Europës ish-komuniste, në Shqipëri sundonte forma më e egër, më totalitare e regjimit komunist. Për 45 vjet në Shqipëri u vendos forma më ekstreme e monizmit apo totalitarizmit më total. Dora e hekurt e sistemit

diktatorial në Shqipëri ndaloi me Kushtetutë dhe Ligj, liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, asgjësoi pronën private, iu shtetëzoi qytetarëve shqiptarë çdo gjë, tokën, pasuritë gjer dhe trojet e shtëpive, dhe vendosi sistemin e hiperkolektivizmit apo të shndërrimit të njeriut në skllav të vërtetë të shtetit socialist". Kujtesa e këtyre njerezve flet për barbarinë kulturore rrënimin e të gjitha kishave, xhamive, teqetë e vendit, ndër më të bukurat dhe më të vjetrat e rajonit duke u instaluar në vend ateizmi i imponuar. Kujtesa historike flet për një rregjim i cili ekzekutoi me gjyq dhe pa gjyq qytetarët shqiptarë mbi dy herë më shumë se sa të gjithë klikat komuniste të Polonisë, Çekosllovakisë, Bullgarisë, Rumanisë, ish Jugosllavisë dhe Hungarisë (përveç kohës së revolucionit). Në pranverën dhe verën e vitit '90, regjimi hoqi nga Kodi Penal largimin nga vendi, si tradhëti e lartë. Ky është momenti kur qindra të rinj që u perpoqën në ekzekutuan në kufijtë e saj, në tentativë për t'u larguar nga vendi dhe në disa raste trupat e tyre të vdekur u shëtitën në rrugët e qyteteve si: Shkodra, Saranda etj. Vetëm pas revoltave studentore, rregjimi ndjeu se nuk mund ti shpëtonte uraganit të lirisë që sillte Rrezimi i Murit të Berlinit ky është momenti kur shqiptarët vërshuan në sheshet e qyteteve duke rrëzuar bustet e diktatorit.

20 Vjetori i rënies së Murit të Berlinit

Në 20 vjetorin e rënies së Murit, në Berlin do organizohen shumë evente speciale dhe ekspozita mbi këtë ngjarje dhe revolucionin paqësor që çoi në riunifikimin e Gjermanisë dhe bashkimin e një Berlinit të ndarë.

Festimet do përfshijnë një ekspozitë mbi ngjarjet e 1989-90 që çuan në shëmbjen e Murit. Zhvillimet në kryeqytetin Gjerman janë të dukshme në cdo cep të tij. Nën parullën "Vizitoni Berlinin. 20 vitet e Ndryshimit" të gjitha ndërtesat qeveritare, amabasadat e huaja, qendrat e reja të qytetit do kthehen në projekte arti, instalime dritash, fasada arti dhe ekspozita të cilat do vënë në dukje zhvillimet dinakime të Berlinit. Këto festime do arrinë kulmin në datën e përvjetorit me 9 Nëntor më një festë të madhe publike në Portat e Brandenburg .



Olli Rehn: BE ankorë stabiliteti dhe demokracie

Këtë vjeshtë Evropa dhe pjesa tjetër e botës do festojnë 20 vjetorin e rënies së Murit të Berlinit, ndryshimet që sollin në Evropë dhe ndarjen e pushteteve në rang botëror.

Gjatë vizitës së tij në Berlin më 28 Prill 2009, Komisionieri i BE për Zgjerimin Olli Rehn deklaroi: "Për të qënë i sigurtë e kam shumë të vështirë të besoj se kanë kaluar 20 vjet që nga rënia e Murit të Berlinit. Akoma i kam para syve imazhet e qytetarëve të Lindjes dhe Perëndimit duke shëmbur murin i cila nuk ndante vetëm qytetin por vëndin dhe kontinentin. Ndryshimet që ka pësuar ky vënd shërbejnë si model i asaj që ka ndodhur në të gjithë Evropën e Bashkuar. Ashtu sic ishte ky qytet i izoluar pas Perdes së Hekurt, ishin dhe shumë vënde të tjera. Sot shumë prej tyre po lulëzojnë në zemër të një Bashkimi Evropian të zgjeruar.

Në radhë të parë, zgjerimi i BE ka shërbyer si ankorë stabiliteti dhe demokracie, por edhe si motor i lirisë personale dhe dinamizmit ekonomik në Evropë. Ky zgjerim ka forcuar zbatimin e ligjit si dhe respektimin e të drejtave të njeriut duke sjellë ndryshime demokratike paqësore dhe duke zgjeruar zonat e lirisë dhe prosperitetit me një popullsi rreth 500 milion. Zgjerimi forcoi edhe rolin tonë në botë si në tregtinë ndërkombëtare apo në lidhje me çështje të ndryshme klimatike, apo mjedisit, si dhe ka rritur rolin tonë në menaxhimin e krizave, vecanërisht në misionet e paqes.

Duhet të them se zgjerimi i BE më përfshirjen e vëndeve të Evropës Qëndrore dhe Lindore nuk përbën vetëm një obligim moral, por ka shërbyer shumë në lidhje me stabilitetin dhe sigurinë e kontinentit, si dhe për zhvillimin ekonomik të tij.

Zgjerimi si dhe hapja e tregjeve të reja të punës koincidon me krijimin e vëndeve të reja për punësim, uljen e numrit të papunëve, përmirësimin e kushteve të jetesës, si dhe uljen e numrit të personave që largohen nga vëndi për arsye punësimi. Edhe pse ka nga ata që vazhdojnë të largohen shumë janë kthyer në vëndin e tyre duke sjelle me vete aftësi të reja dhe frymën e biznesit. Ata që janë akoma jas-

htë vazhdojnë të kontribuojnë për familjet e tyre duke ndimuar në rritjen e nivelit të jetesës në vëndet e reja anëtare.

Përveç faktorëve ekonomik, qytetarët e shteteve të vjetra dhe të reja Anëtare kanë përfituar edhe përsa i përket rritjes së cilësisë së jetesës, si psh përmirësimi i standarteve për ruajtjen e mjedisit dhe të drejtat e qytetarëve. Zgjerimi ka ndikuar edhe në shkëmbimin e njohurive ekonomike, duke filluar me shkëmbimin e studentëve deri në bashkëpunime për kërkime shkencore në rang Evropian.

Në këtë pikë më duhet të theksoj rëndësinë që ka menaxhimi i kujdesshëm i procesit të pranimit në BE. Të gjithë kandidatët për në BE janë të ndërgjegjshëm se përgatitjet për të plotësuar kërkesat e pranimit kërkojnë shumë punë dhe vëditje të vështira. Sipas të dhënave, shtete e reja anëtare kanë qënë të shpejtë dhe efektiv në implementimin e reformave. Disa prej tyre kanë pasur rezultate më të mira në lidhje me aplikimin e legjislationit të BE. Asnjë nuk mund të thote se pranimi i 12 anëtarëve të rinj duke përfshirë 100 milion qytetarë ka qënë perfekt. Është e vërtetë se ka pasur raste të izoluar të moszbatimit të ligjit si dhe mungesa në kapacitetet administrative. Por eksperiencia jonë e zgjerimit 2004-07 ka qënë thelbësore për sa i përket çështjes së pranimit të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë. Ky rajon është shumë i rëndësishëm nga ana strategjike për BE, si pjesë e Evropës.

Nëse eksperiencia me pranimin e 12 shteteve të reja në BE është dicka që do na vlejë, atëherë mund të them se e ardhmja do ketë zhvillime përfituese për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë.

Në një skenar më ta afërt pranimi të reja siç mund të jetë Kroacia, procedurat do jenë më të ngadalta sesa ato të ratifikimit të Traktatit të Lisbonës. Koha është në anën tonë. Ne duhet të vazhdojmë të zgjerohemi në mënyrë paralele. Kjo ka qënë dhe mbetet receta më efikase për ndërtimin e një Evrope të fortë dhe të Bashkuar. Sot Evropa është me të vërtetë një e tërë dhe lirë.

Le ta mbajmë kështu."

5 Vjet Evropë e zgjeruar

Viti 2009 shënon përvjetor historik të dyfishtë. 20 vjet më parë ra Muri i Berlinit. Në Maj të këtij viti do festohet edhe 5 vjetori i zgjerimit të BE si dhe bashkimi i suksesshem i Evropës Lindore dhe Perëndimore. Zgjerimet e viteve të fundit të BE kanë shërbyer si themele në procesin e unifikimit të Evropës, si dhe kanë sjellë përfitime për qytetarët e këtyre vëndeve. Nga ana ekonomike, ky zgjerim ka çuar në rritjen e standarteve të jetesës në Shtetet e reja Anëtare, duke krijuar mundësi eksporti për shtetet e tjera anëtare. Ky zgjerim gjithashtu ka kontribuar në konsolidimin e demokracisë, stabilitetit dhe sigurisë në kontinentin tonë. Një Evropë e Bashkuar ka më shumë peshë në arenën botërore në lidhje me çështje të rëndësishme siç janë ngrohja globale si dhe ekonomia botërore dhe qeverisja e saj. Tani pas 5 vjetësh, BE nuk është thjeshtë më e madhe, por më e fortë, më dinamike më e pasuruar nga ana kulturore. Në kontekstin global, sfida më e madhe ka të bëjë më të rezistuarit ndaj tendencave protektive të cilat do të shkatërronin përfitimet e mëdha që ju ka sjellë zgjerimi qytetarëve me krijimin e një tregu të përbashkët të përbërë nga 500 milion njerëz. "Zgjerimi i 2004 dhe 2007 kanë qënë hapa të një rëndësie historike. Ato i dhanë fund ndarjes së Evropës, ndimuan në konsolidimin e demokracisë si dhe sollën përfitime ekonomike për të gjitha vëndet e BE, për sa i përket rritjes së konkurrencës si dhe hapjes së vëndeve të reja të punës. Ne nuk duhet të lejojmë që kriza botërore të lërë në harresë këtë sukses të pakundërshtueshëm. Të Bashkuar, ne mund ti japim zgjidhje çështjeve globale sic janë ndryshimet klimatike apo problemeve financiare. Të Ndarë nuk do të arrinin asgjë" deklaroi Komisioneri për Ekonomine dhe Financat Joaquín Almunia

Komisioneri për Zgjerimin Olli Rehn është shprehur se: "Zgjerimi ka shërbyer si një spirancë stabiliteti, si udhërrefyes i demokracisë dhe forcës së ligjit në Evropë. Nga ana ekonomike kanë përfituar të dyja palët, shtete e reja dhe ato të vjetra, si dhe ka përfituar Unioni si i tërë. Zgjerimi ka çuar në rritjen e zonave të paqes dhe prosperitetit me një shifër rreth 500 milion njerëz si dhe ka rritur peshën e BE në arenën botërore."

Kane kaluar 5 vjet qëkur BE u zgjerua me 10 shtete të reja nga Evropa Qëndrore dhe Lindore, duke i dhënë fund dekadave të tëra të ndarjes si rezultat i Luftës së Ftohtë. Dy shtete të tjera Bullgaria dhe Rumania, u anëtarësuan në 2007. Një komunikatë mbi "Pesë Vjet të një Evropë të Zgjeruar" flitet mbi përfitimet e mëdha ekonomike për të dyja palët të sjella nga ky zgjerim.



Berlini sot

Ngritja e Murit të Berlinit

Muri Berlinit ka qënë një pengesë fizike që rrethonte plotësisht Berlinin Perëndimor duke e ndarë atë nga Republika Demokratike e Gjermanisë (Gjermania Lindore.)

Perëndimore humbën vëndet e punës Qeveria e Gjermanisë Lindore , pretendonte se Muri ishte një : mase Antifashiste), e cila kishte si qëllim të ndalonte agresionin që vinte nga Perëndimi.

teteve në botë gjatë viteve 80, quan në protesta massive në Bllokun Lindor në veçanti në Gjermaninë Lindore. Me 9 Nëntor 1989, kur qeveria e Gjermanisë Lindore anoncoi lajmin së qytetarët e



Të dy kufinj të simbolizuan atë që u quajta Perdaja e Hekurt mes Gjermanisë Lindore dhe Perëndimore. Muri i mbajti të ndarë të dy Gjermanitë për më shumë se një çerek shekulli duke nisur që nga dita e parë e ndërtimit në 13 Gusht 1961 deri në ditën e shëmbjes së Murit me 9 Nëntor 1989. Ndërtimi i Murit filloi me 20 Nëntor, 1961. 2 muaj më parë, me 15 Qershor 1961, Sekretari i Parë i Partisë Socialiste të Bashkuar dhe shefi i Këshillit të Shtetit Walter Ulbricht deklaroi gjatë një konference shtypi se “nuk ka asnjë përpjekje për të ngritur ndonjë mur”.

Nga regjistrimet e një telefonate mes Nikita Khrushchev dhe Ulbricht me 1 Gusht 1961, ku mësohet se ishte Khrushchev që propozoi ndërtimin e murit. Të Shtunën me 12 Gusht 1961, Ulbricht firmosi urdhrin për mbylljen e kufirit dhe ndërtimin e murit.

Gjatë ndërtimit të murit ushtarëve ju ishte dhënë urdhër të qëllonin këdo që përpuqej të kapërcente atë. Në Kufirin mes Gjermanisë Lindore dhe Perëndimore u ngritën gardhe me xhëmba, mure si dhe zona të minuara.

Shumë familje u ndanë, ndërsa shumë Berlinezë Lindorë të Punësuar në pjesën


Një tjetër justifikim zyrtar i përdorur për Murin ishte edhe aktiviteti i agjentëve të Berlinit Perëndimor në Europën Lindore. Sipas të dhënave zyrtare 98 veta janë konfirmuar të vrarë në përpjekje për të kapërcyer Murin për në Berlinin Perëndimor. Burime të tjera konfirmojnë 200 viktima.

Kolapsi ekonomik i sistemit komunist si dhe ndryshimet e balancave të push-

saj mund të vizitonin anën Perëndimore turma të gjermanëve Lindorë kapërcyen Murin dhe u bashkuan në festime edhe nga Gjermanët Perëndimorë. Në javët në vijim pjesë të murit u shëmbën nga qytetarët e ekzaltuar si dhe nga koleksionistët ndërsa pjesa tjetër u shëmb më vonë. Shëmbja e Murit të Berlinit hapi rrugën për Unifikimin e Gjermanisë, e cila u zyrtarizua me 3 Tetor 1990.



Simbolika e termit Perdja e Hekurt.



Termi Perde e Hekurt është përdorur për të treguar kufirin që ndante Paktin e Varshavës nga vendet e NATO-s

Duke filluar nga viti 1945 deri në përfundim të luftës së ftohtë në vitin 1991. Perdja e Hekurt përfaqësonte një ndarje ideologjike dhe fizike të Evropës pas Luftës së Dytë Botërore. Në lindje të Perdes së Hekurt ndosheshin vendet e lidhura ose të influencuara nga Bashkimi Sovjetik duke përfshirë edhe Gjermaninë Lindore, Çekosllavakine, Poloninë, Hungarinë, Bullgarinë, Rumaninë dhe Shqipërinë (deri në 1960 , vit kur bëme alenacë me Kinën). Jugosllavia edhe pse vënd komunist nuk konsiderohej pjesë e Bllokut Lindor ose si e vendosur pas Perdes së Hekurt. . Josip Broz Tito, Presidenti i Jugosllavise në atë kohë, arriti të mbante akses me Perëndimin edhe pse drejtonte

një vënd komunist. Vëndet e tjera në perëndim të Perdes së Hekurt kishin sisteme demokratike



Termi "Perde e Hekurt " u përdor nga politikani Gjerman Lutz Graf Schwerin von Krosigk, dhe më pas nga Win-

ston Churchill, i cili e përdori për herë të parë në një fjalim të bajtur në Mars 1946. Termi fillimisht u përdor për të përcaktuar pengesën metalike që ndante kontinentin në dy pjesë, por shumë shpejt u u kthye në term referues edhe të një pengese ideologjike Kur Churchill ju referua termit për here të parë nuk po përipiqej citonte von Krosigk. Në një telegram dërguar Presidentit amerikan, Harry S. Truman, Churchill flet rreth situatës në Evropë duke u shprehur "Një perde e hekurt ka rënë mbi ne në front. Nuk e dimë se çfarë po ndodh pas saj" . Kjo është hera e parë e përdorimit të këtij termi zyrtarisht. Gardhi I Perdes së Hekurt i cili ndante vëndet e Evropës Lindore dhe Perëndimore, zgjatonte me mijëra kilometra, dhe sidomos në pjesën Gjermane aty ku Muri I Berlinit u kthye në symbol të Perdes së Hekurt. ishte shumë i përforcuar. Në disa zona të tjera ishte vecse një gardh I thjeshte hekuri, ndërsa në vënde të tjera ruhej me masa sigurie të larta dhe mund të kalohej vetëm nga ata që kishin leje qeveritare.

Shëmbja e Perdes së Hekurt filloi me

emigrimin e mijra Gjermanëve Lindorë nga Hungaria për ne Gjermaninë Perëndimore , në verën e vitit 1989.

Ju lutem vizitoni faqet e internetit të poshtëshënuara ose kontaktini Delegationin e Komisionit Evropian në Tiranë

www.delalb.ec.europa.eu

www.europa.eu

www.ec.europa.eu/enlargement

www.eu2009.se

Delegacioni i Komisionit Evropian në Tiranë, Shqipëri:

ABA Center, Rr. Papa Gjon Pali II, Kati 17

Tiranë , Shqipëri

Telefon: (355) 4 2228320 or 2230871 - 2228479 -

2234284 - 2229851 Fax: (355) 4 2230752 or 2274412

e-mail: Delegation-Albania@ec.europa.eu

Botues: Komisioni i Delegacionit Evropian në Shqipëri

Opinionet e shprehura në këtë botim nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëvështrimin e Komisionit Evropian

Nëse doni të merrni botimin e ardhshëm ju lutem na shkruani në

adresën e-mail: suela.thanasi@ec.europa.eu

ose kontaktini Delegationin e Komisionit Evropian në Shqipëri